



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 991/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dega në Prishtinë, paraqitur kundër Fatmir Bytyqi, Komina e Lipjanit për shkak të votimit publikë , parregullsive për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuara ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dega në Prishtinë.

### Arsyetim

PZAP-i , më datën 02.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovë me të cilën pretendohet se me datën 01.12.2013 në Komunen e Lipjanit , në vendvotimin nr.1301e/01, Fatmir Bytyqi ka votuarë në mënyr të hapur (publike),përkundër që nga komisioni i është kërkuarë të hyjë brenda kabinës së votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga Institutit Demokratik të Kosovës dega në Prishtinë, andaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i përgjithshëm dhe i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse nga shkaku se parashtguesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë shtese të ankesës së parashtruar, me të cilat do të mund të administrohej lënda, ose do të mund të verifikohet vërtetësia e shkeljes së pretenduar. Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar shkeljet qe janë cekur ne ankesë , PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 991/2013 më datën 04.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



***Këshillë Juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*